

# EKOMARM Naxos Tonachello

## Veshje me bazë elastomerike

### Karakteristika

**EKOMARM NAXOS TONACHELLO** është një veshje e vazhdueshme për sipërfaqe muri të jashtme e të brendshme me bazë polimerësh akrilikë për t'u përdorur me ujë, oksidë ngjyruar, pluhur kuarci e granilë mermeri. Lloji i lidhësit i përdorur në këtë rast bën që produkti të ketë qëndrueshmërinë e duhur ndaj alkalineve dhe agjentëve atmosferikë, të jetë i aplikueshëm, i punueshëm dhe të ngjeshet mirë; përdorimi i pigmenteve solide në dritë dhe në praninë e alkalineve siguron stabilitetin e bojrave edhe mbi mure që janë të ekspozuar shumë ndaj rrezatimeve të ndritshme e ndaj motit të keq. **EKOMARM NAXOS TONACHELLO** është i përshtatshëm për t'u përdorur mbi aglomeratet ndërtimore të përbëra nga një suva treshtresore tretësire të përzier ose të barsvlefshme, suva tretësire të përzier me rërë të situr e të hedhur me perdah fine, suva me allçi për anën e brendshme, elemente të parafabrikuara në konglomerate çimentoje me sipërfaqe të ngjeshura të njëtrajtshme e të sheshta.

### Të dhëna mbi produktin

Ambalazhimi	bidonë nga 20 kg
Konsumi për 1.2 mm trashësi	2.2 kg/m <sup>2</sup>
Pesha specifike	1.91 kg/l ± 0,10
Thërrmimi	07 – 1.2 mm

### Përgatitje e sipërfaqeve

Suvatë duhet të lihen të staxhionohen për të paktën 4-6 javë, në mënyrë që të neutralizohen në sipërfaqe nëpërmjet karbonatizimit natyror. Edhe riparimet e reja duhet të lihen të maturohen.

Sipërfaqet e reja murore: të pastrohen me kujdes duke hequr çdo gjurmë pluhuri, papastërtie apo pjesësh të ngritura si dhe ato që nuk ngjeshen mirë. Kontrollon nëse muri është i thatë si duhet dhe, në rast se sipërfaqja është shumë absorbuese t'i jepet një dorë apretim njëtrajtësues dhe konsolidues EKOFOND B200. pasi të kenë kaluar 8 orë të rrafshohet gjithçka e ngritur 3 mm mbi sipërfaqe me EKOCOLL.

Sipërfaqet murore të lyera dhe pjesërisht të degraduara: të hiqet çdo gjurmë boje e papërputhur mirë dhe çdo grryerje e mundshme; kur ka myk është me vend të bëhet një trajtim me solucion HIGJENIZUES. Pastro me kujdes pluhurin dhe papastërtitë, sigurohu që muri është krejtësisht i thatë dhe fikso sipërfaqen me një dorë EKOFOND B200. 8 orë më pas stuko difektet më të mëdha me EKOCOLL. Pas 24 orësh përdor **EKOMARM NAXOS TONACHELLO**.

## Mënyra e përdorimit

**EKOMARM NAXOS TONACHELLO** është i gatshëm për përdorim dhe nuk kërkon hollim. Ripërzieje plotësisht produktin derisa të arrish një masë homogjene dhe shtrihe me një dorë të vetme me mistri çeliku inoks. Shesho me mistri plastike dhe, para se **EKOMARM NAXOS TONACHELLO** të krijojë një shtresë në sipërfaqe, të lastrohet me perdah për të arritur efektin e dëshiruar. Mos e përdor produktin në mure që janë në diell apo në mjedis me temperaturë që mund të zbresë nën 5° C. Pas përdorimit sipërfaqet duhet të ruhen nga shiu intensiv të paktën për 48 orë. Të lahen veglat e përdorura me ujë menjëherë pas përdorimit.

## Të dhëna teknike dhe aplikative

* Paketimi	Kovë 20 kg
* Pamja	Pastë e pigmentueshme – ngjyrë e bardhë
* Peshat specifike	1.91 ± 0.10 kg/l
*Konsumi i mesëm për 1.2 cm trashësi	2.2 kg/m <sup>2</sup>
* pH	9.1
* Ekstrakt i thatë (në peshë)	83% ± 0.10
*Thërrmimi	0.7 – 1.2
* Përshkueshmëria nga avulli i ujit	μ < 75

## Paralajmërime

- \*\* Mos e përdor mbi sipërfaqe të ngrira, në fazë shkrirjeje apo që mund të ngrihen gjatë 24 orëve të ardhshme
- \*\* Mos e përdor mbi sipërfaqe tepër të nxehta, të lagura, ku fryn erë e fortë apo në pishë të diellit
- \*\* Mos e përdor mbi sipërfaqe mbajtëse të paqëndrueshme, të thërrmueshme e me pluhur, nëse nuk janë përforcuar më parë
- \*\* Mbro sipërfaqen e përpunuar nga shiu intensiv për të paktën 24 orë
- \*\* Mbi faqet e shtrira për të maskuar linjën e rifillimit, ndërprej përdorimin në përputhje me ullukët apo shtesat
- \*\* Mos e përdor mbi sipërfaqe pre të lagështirës në rritje
- \*\* Mos i lër kovat në diell para fillimit të punës
- \*\* Laj me ujë veglat e përdorura menjëherë pas përdorimit

**Vërejt!** Vlera të tilla u referohen provave laboratorike në mjedis të kushtëzuar dhe mund të modifikohen ndjeshëm nga kushtet e vënies në përdorim.